

PËLLUMB XHUFI

“KOMBI SHQIPTAR”: NJË VËSHTRIM NGA MESJETA

Në sytë e të huajve, shqiptarët përfaqësonin qysh në mesjetë një popull fort mirë të dallueshëm nga popujt fqinjë, grekët e sllavët. Në vitin 1331, Guljelmi i Adës i konsideronte shqiptarët si një “komb”, madje si një “komb i madh” (*Albanenses autem, quia major natio est*)¹. Në të njëjtën kohë edhe historiani bizantin, Georg Akropoliti, fliste për një “komb shqiptar” (τὸ ἔθνος τῶν Ἀρβανιτῶν)². “Kombi shqiptar” (Ἀλβανικὸ ἔθνος) përmendet më 1757 në një sixhil të Patrikut Serafim II, i cili ishte shqiptar nga Delvina³, si dhe në shumë dokumente venedikase, spanjolle e papale të shek. XVI-XVIII. Një element të ri, atë të rrënjëve historike të shqiptarëve, e sjell një tjetër dokument i fundit të shek. XIV, Panegjiriku i Manuel Paleologut. Shqiptarët, sipas tij, ishin një “farë ilire” (Ἀλβανοὶ γένος ἰλλυρικόν)⁴. Një shekull më vonë, një burim perëndimor, duke folur për Himarën, thotë se “banorët e saj janë Ilirë, apo si quhen sot, Shqiptarë”⁵.

Por, përpos të huajve, në vitin 1595 një shqiptar, kavalier Mark Gjini, fliste për atë që ai e quan “kombi im shqiptar” (*la mia nazione*

¹ Brocardus, “Directorium ad passagium faciendum”, në: *Recueil des Historiens des Croisades. Documents Armeniens*, tome II, Paris: 1906, f. 484.

² Georgios Akropolites, *Chronike Syngraphe*, ed. B. G. Teubner, Lipsiae: 1903, f. 143.

³ Vassilis Baras, *To Delvino tes Voreiou Epeirou kai ai geitonikes tou perioches*, Athinë: 1966, f. 52.

⁴ Spiridon Lambros, “Anonymou Panegyrikos eis Manouel kai Joannen VI Palaiologous”, në: *Palaiologeia kai Peloponnesiaka* 3, 1926, f. 194. Të njëjtin barazim, Shqiptarët të njëjtë me Ilirët (Ἰλλυριοὶ οἱ Ἀλβανῖται), e gjejmë edhe në një listë emrash gjeografikë të shek. XV, shih: A. Diller, “Byzantine List of geographical Names”, në: *Byzantinische Zeitschrift*, 63, 1970, f. 33.

⁵ “*Accole ejus Illyrii, quos nunc Albaneses noncupant*”, shih: Injac Zamputi, *Dokumente për Historinë e Shqipërisë, 1479-1506*, pjesa II (1499-1506), Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Tiranë: 1979, f. 217.

Albanese)⁶. Para tij, në një letër për Mbretin e Francës (1537), një personazh kozmopolit, gjenerali Merkur Bua që i kishte shërbyer me stratotët e tij thujse gjithë sovranëve të Evropës, vetëdeklarohet si “shqiptar” bashkë me 100 kalorësit e tij⁷. Rreth një shekull më vonë, pinjoll i një familjeje plot histori nga Dhërmiu i Himarës, Gjon Bixhili, njoftonte venecianët për masat që ishin marrë nga “*të gjithë ne shqiptarët*” (*tutti noi Albanesi*), për të ndjekur lëvizjet e flotës osmane drejt ujërave të Vlorës, duke treguar se vetëdija e qenies shqiptare ishte e fortë edhe në një nga trevat shqiptare më të hapura ndaj botës së jashtme⁸.

Rastet e dëshmuara të vetëdeklarimit të identitetit kombëtar, janë padyshim shprehje e ekzistencës së një vetëdijeje të bazuar në ndjenjën objektive të përkatësisë në një grup të caktuar njerëzor. Këtë ndjenjë përkatësie e shprehin në mënyrë të prekshme disa krerë shqiptarë në shërbim të Venedikut, të cilët në vitin 1480 refuzuan t’i bindeshin urdhërit për të arrestuar një kolegun e tyre, Teodor Buan, pasi “*i përkisnin të njëjtës kombësi*” (*per esser de una nation*)⁹. Për të mbetur në të njëjtën suazë, po kujtojmë këtu një histori të çuditshme “shqiptare”, të ndodhur në vitin 1482 në Peloponez. Atë vit, kishte shpërthyer një grindje midis Buziqëve, komandantë trupash stratiote, dhe disa krerëve të tjerë shqiptarë. Ndërhyn në konflikt një komandant turk i krahinës, që ishte edhe ai “me kombësi shqiptare” (*che he de nation Albanese*) dhe njëherësh kushëri i Buziqëve në fjalë (*parente de questi Busichei*). Ky tentoi të pajtojë Meksha Buziqin me krerët e tjerë. Për këtë qëllim, ai së bashku me një nga subashët kryesorë të Moresë, gjithashtu me kombësi shqiptare (*etiam de nation Albanese*), i shkruan letër Pjetër dhe Dumë

⁶ Injac Zamputi, *Dokumente të shek. XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë*, vëll. II (1593-1602), Tiranë: 1990, f. 81.

⁷ “*capitaine de cent hommes de guerre à cheval albanoy*”, siç shprehet në një deklaratë të shkruar nga ai vetë më 17 qershor 1506, shih: Émile Legrand, *Bibliographie hellénique*, vëll. I, Paris: Ernest Leroux, 1885, f. CCV.

⁸ “*e cosi noi tutti Albanesi, perche havemo sospetto, habbiamo messo gente in tutte le rive*”, *Archivio di Stato di Venezia (ASV), Dispacci di Ambasciatori, Rettori e altre cariche*, b. 25 (v. 1644): letër nga Dhërmiu e Gjon Bixhilit, 20 qershor 1644.

⁹ “*...excusandose non li aver possuti prender e questo per esser de una nation non li ha voluto prender*”, shih: Constantin Sathas, *Documents inédits ou peu connus relatifs à l’histoire de la Grèce au moyen âge*, vëll. V, Paris: 1885, f. 59.

Buziqit, vëllezër të Mekshës në fjalë¹⁰. Po atë vit, komandanti venecian i kështjellës së Nauplionit në More, refuzoi t’i kthejë komandantit turk të hinterlandit disa bujq të ikur nga zotërimet e tij, duke u justifikuar se nëse kjo ndodhte, stratiotët e tij, që ishin shqiptarë, do rezistonin e do viheshin në mbrojtje të bashkëkombësve të tyre.¹¹ Kuptohet që vetëdija e përkatësisë së njëjtë etnike, materializohej në realitetin e përditshëm në aleanca, krushqi e beteja të përbashkëta, të cilat për pikënisje kishin pikërisht vetëdijen e kësaj bashkësie dhe gjithashtu, për rezultat, kishin forcimin e saj.

Sigurisht, koncepti “komb” që ne ndeshim në burimet mesjetare, nuk përputhet në gjithçka me konceptin modern të kombit. Por, edhe atëherë në themel të tij qëndronin elementë të tillë qenësorë, si gjuha, zakonet, sjelljet shoqërore, institucionet sociale-juridike dhe, domosdo, referencat historike. Shqiptarët kishin padyshim gjuhën e tyre, që sipas Guljelmit të Adës (1332), ishte krejt tjetër dhe e ndryshme nga latinishtja (*Albanenses aliam omnino linguam a latina habeant et diversam*)¹². Në vitin 1285, një qytetar nga Raguza deklaronte se kishte dalluar dikë në mal që thërriste në gjuhën shqipe (*Audivi unam vocem clamantem in monte in lingua Albanesca*)¹³. Unicitetin e gjuhës shqipe e shpreh edhe një marinar dalmatin, i cili, më 1644, tregonte se si kishte takuar në Himarë “një shqiptar për nga gjuha” (*Un Albanese per la lingua*)¹⁴. Gjuha si moment

¹⁰ “*Il Voivoda de qual, che he de nation Albanese, parente de questi Busichei capi de Stratioti, ha temptà de reconciliar Mexa Busichi, capo de la seta de i Cladioti cum altri de suo compagni principali, et redur quelli a gratia del flamburar; e sopra questo esso Vaivoda et uno altro de i principal subassi de la Morea, etiam de nation Albanese, scripseno et mandono sue lettere a Piero e Duma Busichi cavalieri, germani del ditto Mexa*”, shih: C. Sathas, *Documents ...*, vëll. VI, Paris: 1885, f. 188.

¹¹ “*io non ho voluto assentir, per non indur scandalo fra nui, per rispetto de questi Albanesi, i qual per difender ed excusar la sua nation, faria resistentia, et potria intravegnir scandalo et occision fra Turchi et nostri...et per esser i ditti Albanesi de nation Albanese non li posso metter man adosso con le mie forze de i Stratioti, che sono de quella medema generation et parenti*”, shih: *po aty*, f. 196, 211.

¹² Brocardus, “*Directorium ad passagium faciendum ...*”, f. 484.

¹³ Constantin Jireček, *Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters*, I. Teil, Wien: 1901, f. 43.

¹⁴ *ASV, Dispacci degli Ambasciatori, Rettori ed altre cariche, Corfù*, b. 25 (1644): dëshmi e marinarit Zuanne Miagastovich, 15 qershor 1644.

identitar, ndjehej fort si e tillë nga vetë shqiptarët. Në vitin 1742, misionari Giuseppe Schirò, vikar papnor në Himarë, shkruante se “gjuha epirote apo ndryshe shqiptare, është kryekëput e ndryshme jo vetëm nga greqishtja, por nga të gjitha gjuhët që sot përdoren në Evropë e në pjesë të tjera të botës”¹⁵. Një kujdes e shqetësim, thuaj-thuaj rilindas, tregon ndaj gjuhës shqipe Frang Bardhi, i cili në 1635 jepte alarmin për bjerren dhe prishjen e saj: “*keshë me ndihmuem mbë nja anë gjuhënë tanë, gji po bdaretë e po bastardhohetë*”¹⁶.

Përveç gjuhës, shqiptarët veçoheshin nga popujt e tjerë edhe për sjelljen dhe zakonet e tyre krejt të veçanta. Përgjithësisht, shqiptarët gjykoreshin si popull luftëtar dhe mjaft i ashpër¹⁷. Në Statutet e Ankonës (shek. XV), emigrantëve shqiptarë u ndalohej të mbanin armë, pasi, siç shkruhej aty, “kombi shqiptar nuk e ka për gjë të bëjë keq e të ngjyjejë duart me gjak njerzor”¹⁸. Në fakt, ndodhte që shqiptarët konfliktoheshin me të huajt, për arsye që këta nuk arrinin t’i kuptonin, por që rridhnin nga kodi i fshehtë i tyre. Kështu, në shtator 1436, pikërisht në Ankonë, shqiptari Giorgio plagosi italianin Tadiolo de Mucciolino. Arsyeja, aq sa ishte banale nga këndvështrimi i gjykatësve italianë, po aq ishte e rëndë dhe parimore nga këndvështrimi shqiptar. Në fakt, në çastin e sulmit, shqiptari kishte lëshuar ndaj viktimës fjalët “*Traditor di merda*”¹⁹. Prej këndej, mund të nxirret konkluzioni, që italianin i kishte dalë fjale shqiptarit për ndonjë ujdë të mëparshme, apo kishte tradhtuar besimin e tij. Mirëpo, në kodin e shqiptarit, tradhtia (thyerja në besë) konsiderohej krim ndër më të rëndët. Statutet e Shkodrës (shek. XIV), e ndëshkonin formën më të lartë të tradhtisë, tradhtinë ndaj atdheut, me prerje koke e

¹⁵ Mons. Giuseppe Schirò, “Notizia distinta degl’Italo-Greci e degl’Italo-Albanesi”, në: C. P. Karalewsky, “Documenti inediti per servire alla storia delle Chiese italo-greche”, në: *Bessarione*, XIV, fasc.2 (1910), f. 394.

¹⁶ Frang Bardhi, “Parathënia”, f. III, në: Bardhyl Demiraj, *Dictionarium Latino-Epiroticum (Romae 1635) per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër: 2008, f. 75.

¹⁷ “*inclinati alla guerra...che d’altra cosa maggiormente non si diletano che delle armi*”, shih: É. Legrand, *Bibliographie hellénique*, vëll. V, Paris: 1903, f. 357; M. Lacko, “Alcuni documenti riguardanti l’arcivescovo di Ochrida Atanasio”, në: *Orientalia Christiana Periodica*, 33, 1967, f. 626.

¹⁸ A. Ducellier-B. Doumerc-B. Imhaus-J. De Miceli, *Les chemins de l’exil*, Paris: Armand Colin, 1992, f. 340.

¹⁹ *Po aty*, f. 345.

konfiskim të pasurisë (kreu 228). Por, ato ndëshkonin po ashtu shumë rëndë fyerjen me fjalën “tradhtar”. Në këtë rast, kundravajtësi dënohej me një gjobë prej 500 hiperperësh (kreu 92), ndërkohë që goditja me grusht dënohej me vetëm 2 hiperperë (kreu 242)²⁰. Episodi i Ankonës, pra, ngërthehej në një qerthull të së drejtës zakonore shqiptare, sigurisht të panjohur nga gjykatësit ankonitanë, ku besa, tradhtia dhe hakmarrja ishin elementë thelbësorë të saj²¹.

Akoma më tej, shqiptarët dalloheshin nga të huajt edhe për nga paraqitja, nga veshja dhe armatimi i veçantë i tyre. Rregullorja e “Regjimentit Mbretëror Maqedon”, që u krijua më 1737 nga Mbreti i Napolit me rekrutë të mbledhur nga Himara dhe popullsitë e tjera shqiptare të besimit ortodoks, përcaktonte që këta duhet të visheshin me uniformë “alla shqiptarçe” (*Questo Regimiento doverà vestirse à la Albanese*)²². Strategu prusian, konti Schulemburg, që përgatiti mbrojtjen e Korfuzit nga osmanët, më 1715, udhëzonte që mbrojtësit e kështjellës, që nuk ishin vetëm shqiptarë, të mbanin të gjithë “beretta all’Albanese”²³. Siç duket, pamja e “beretave shqiptare” ndikonte psikologjikisht tek kundërshtari. Një provë akoma më të qartë, se sa të dallueshëm ishin shqiptarët në raport me të tjerët, na e jep inventari i armëve dhe i sendeve personale të kapëdanit shqiptar Odise Andruco (*capitan Albanese Andruzzo*) nga Preveza, i regjistruar pas arrestimit të tij nga autoritetet venedikase të Zadarit, më 6 tetor 1792: veç pushkës, shpatës, dy pistoletave të praruara e një arsenali të tërë municionesh e sendesh personale, Andrucos i ishin regjistruar një qyrk i ri, një palë kallca kadifeje me kopsa argjendi të punuara me filigranë, pesë këmisha,

²⁰ Lucia Nadin (bot.), *Statuti di Scutari*, Corpus Statutario delle Venezie, Roma: Viella, 2002, f. 147, 113, 150.

²¹ Në fakt, veç “tradhtisë”, në Statutet e Shkodrës gjejnë vend edhe “besa” (besare) dhe “hakmarrja” (vendetta), shih: *po aty*, f. 156, 157.

²² Raul Manselli, “Il Reggimento Albanese Real Macedone durante il regno di Carlo di Borbone”, në: *Archivio Storico delle Province Napoletane*, 65, 1940, f. 165.

²³ Conte di Schulemburg, “Piano di difesa della piazza di Corfù”, në: *Biblioteca Nazionale Marciana*, Mss. It. Cl. VII, 478 (=8194), col. 2^f.

një veshje dhe një palë çorape (*cerappe*). Secila nga këto armë e këto veshje përcaktohet qartazi si e “stilit shqiptar” (*all’Albanese*)²⁴.

Gjuha, kultura, zakonet e ndryshme përbënin thelbin e të qenit ndryshe të shqiptarëve në kontekstin ballkanik e evropian. Historia, nga ana e saj, u solli atyre ballafaqime shpeshherë të ashpra me fqinjët sllavë e grekë. Ndërgjegja kombëtare ndër shqiptarë u ushqye edhe nga konflikti me ta. Qysh në shek. XIV flitet për një armiqësi gati patologjike mes sllavëve dhe shqiptarëve: këta të fundit, sipas Guljelm Adamit, besonin se i shenjtëronin duart e tyre duke i lyer me gjak sllav²⁵. Por nuk binin më poshtë në ndjenjat e tyre “antishqiptare” edhe sllavët, përkatësisht serbët. Despoti serb i Janinës, në vitet 1370, Thoma Preljuboviçi, mori nofkën “shqiptarëvrasësi” (albanoktoni), për krimet që kreu mbi shqiptarët e Janinës²⁶.

Marrëdhëniet me grekët nuk ofrojnë skena të tilla ballafaqimesh të dhunshme, të paktën jo deri në kohët moderne. Përzierjet e popullsisë, të shkaktuara sidomos pas emigrimit masiv të shqiptarëve drejt Greqisë, në shek. XIV, si dhe njësia në fëmijë me shqiptarët e Jugut, që deri në shek. XVI ishte pothuaj e plotë, shërbenin padyshim si një paliativ, që zbuste konfliktet dhe që, ndonjëherë, ua vështirësonte vëzhguesve të huaj dallimin mes shqiptarëve dhe grekëve. Nga ana tjetër, në Evropë ishte bërë zakon, që popullsitë e besimit ortodoks të Lindjes bizantine, të cilësoheshin “greke”, sigurisht pa nënkuptuar me këtë identitetin kombëtar të tyre, por atë fetar²⁷. Kjo praktikë vazhdoi edhe në kohët e reja, duke krijuar një konfuzion që i helmoi marrëdhëniet mes grekëve, të cilët besonin se ishin mishërimi i vetëm i botës bizantino-ortodokse, dhe popujve të tjerë ballkanikë, përfshirë shqiptarët²⁸.

Një konfuzion i tillë, që buronte nga besimi i njëjtë, e shqetësonte ndërgjegjen “kombëtare” të mjaft shqiptarëve të mësuar, në kapërcimin

²⁴ Konstantin Mertzios, “Neai eideseis peri tou Llabrou Katsone kai tou Androutsou”, në: *Pragmateia tes Akademias Athenon*, tom 23, nr. 3, Athinë: 1959, f. 29, 69, 96-98.

²⁵ “*ipsi omnes et ipsorum singuli in predictorum Sclavorum sanguine manus suas crederent consecrare*”, Brocardus, “Directorium ad passagium ...”, f. 484.

²⁶ “Tò Chronikon ton Joanninon”, në: F. Pouqueville, *Voyage dans la Grèce*, vëll. 5, Paris: 1821, f. 232, 242.

²⁷ Cyrill Mango, *La civiltà bizantina*, Bari: Laterza, 2009, f. 36.

²⁸ George Castellan, *Histoire des Balkans (XIV^e –XX^e siècle)*, Paris: Fayard, 1991, f. 260.

nga Mesjeta në kohët moderne. Giuseppe Schirò insistonte, në fillim të shek. XVIII, se “gjuha shqipe ishte krejtësisht e ndryshme nga gjuha greke, si dhe nga të gjitha gjuhët e tjera të botës”. Po aq të ndryshme, vazhdonte ai, ishin edhe zakonet e shqiptarëve në krahasim me ato të grekëve.²⁹ Njësia në fe me grekët, krijonte rrezikun e njësimimit në kombësi për ortodoksët shqiptarë, duke përfshirë këtu edhe arbëreshët e Italisë. Ndaj, pas Schiroit, të tjerë arbëreshë, si Angelo Masci, Michele Scutari, Giuseppe Crispi dhe vetë Jeronim de Rada i kushtuan vëmendje evidentimit të ndryshimeve thelbësore, që ekzistonin midis “kombit” shqiptar dhe “kombit” grek³⁰. Njëherësh me Giuseppe Schirò-in, në vitet 1740 P. Giorgio Guzzetta, kishte shkruar sprovën e tij *L'osservanza del rito presso gli Albanesi d'Italia*, ku mundohet të provojë se midis këtyre dy kombeve nuk ekziston asnjë lidhje a afërsi, përkundrazi. Shqiptarët, sipas tij, ushqenin një urrejtje e antipati natyrale kundrejt grekëve, që buronte nga ndjenja e epërsisë së të parëve mbi të dytët (ai i quan grekët: *gente effeminata*), përsa i përket aftësive luftarake, kodeve morale, sjelljeve shoqërore dhe virtyteve të paarritshme të grave shqiptare³¹. Edhe kjo ndjenjë e epërsisë mbi të tjerët, ishte një tipar dallues i shqiptarëve, që u binte në sy të huajve. “*Jetojnë mes skamjes e mjerimit, e megjithatë janë krenarë e kryelartë, sikur të ishin princër të shquar*”, shkruante më 1752 nga Himara misionari Silvestro Costantino Slade³².

Vetëdija e fortë e bashkësisë, i shtynte shqiptarët të kërkonin njeri-tjetrin, e të refuzonin të huajin. Në shek. XVII, besimtarët e klerikët shqiptarë i kërkonin Romës të mos dërgonte në Shqipëri misionarë e priftërinj të huaj, pasi ata ishin “me kombësi tjetër, me gjuhë tjetër e me

²⁹ “*L'idioma Epirotico o sia Albanese è totalmente differente, non solo dal Greco, ma ancora da tutti gli altri linguaggi che sono in Europa e nelle altri parti del mondo...Non meno differenti da quelli delle altre nazioni, e specialmente dalli Greci, sono i costumi degli Albanesi*”. Mons. G. Schirò, “Notizia distinta degl'Italo-Greci ...”, f. 394.

³⁰ Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Tiranë: Përpejka, 2009, f. 155.

³¹ P. Giorgio Guzzetta, *L'osservanza del rito presso gli Albanesi d'Italia*, Palermo: 2007, f. 35, 36.

³² “*Da tante miserie circondati, pure anno una superbia ed alteriggia, come fossero gran Principi*”, shih: Peter Bartl, “Zur Topographie und Geschichte der Landschaft Himara in Südalbanien”, në: *Münchener Zeitschrift für Balkankunde*, 7-8, 1991, f. 336.

zakone të tjera”³³. Këta vinin në Shqipëri për interesin e vet, duke u zënë vendin klerikëve shqiptarë, të cilët mes shumë sakrificash kishin studiuar në shkolla të huaja me qëllimin e vetëm që të ktheheshin në Shqipëri e të bëheshin “drita, nderi dhe lavdia e atdheut” (*per esser poi honore, decoro et lume della patria*)³⁴. Këtë idealizëm “patriotik” e gjejmë më 1578 edhe tek pleqtë e Priskës, kur i kërkonin Papës t’u caktonte për ipeshkëv Aleksandër Kuesin, i cili ishte nga toka shqiptare (*di questo nostro liogo albanese*), dhe që banorët e asaj treve e donin ngaqë “ishte lindur dhe ishte ushqyer në të njëjtin komb...dhe i përkiste së njëjtës kombësi” (*il qualle è nato e nutrito di tal nazione...essendo della nazione istessa*)³⁵. Nga ana e tyre, stratotët shqiptarë nën Venedikun nuk pranonin të luftonin veç nën urdhërat e kapedanëve që ata i kërkonin vetëm me kombësi shqiptare. Në rast ekstrem mund të pranonin komandantë italianë, por jo kroatë dhe kurrsesi grekë³⁶. Në nëntor 1647, në një letër nga Parisi, që u interceptua nga Proveditori i Përgjithshëm venecian i Dalmacisë e i Shqipërisë, Leonardo Foscolo, Gjergj Vladani i shkruante si më poshtë një miku të tij në Shqipëri: “Mora vesh se popullsitë e atyshme u kanë kërkuar armë venecianëve për të luftuar si dhe u kanë propozuar të vihen nën pushtetin e tyre. Por, mos, mos ta bëjnë këtë, sepse besomë, do të vënë mbi zverk një zgjedhë akoma më të rëndë dhe do ta humbin edhe atë liri që sot gëzojnë. Prandaj thuaju atyre nga ana ime... që t’i marrin armët dhe municionet nga venecianët, por të bëjnë kujdes që të mos fusin venecianë në kështjellat e qytetet që do pushtojnë, por të emërojnë komandantë e qeveritarë shqiptarë: përndryshe do ta pësojnë si dalmatinët dhe të tjerë popuj nën Venedikun, të cilët kanë mbetur pa emër e pa nder”³⁷.

³³ “*senza nostra petitione vengono in queste nostre parti vescovi, abbati et altri, alieni di natione, alieni di lingua, alieni di costumi...*”, shih: I. Zamputi, *Dokumente ...*, vëll. II, Tiranë: 1989, f. 300.

³⁴ *Po aty*, f. 309.

³⁵ *Po aty*, f. 344.

³⁶ “*molti Greci non voleno stare sotto Albanesi, et al simel molti Albanesi non se degna star sotto altri, che quelli del so parentà*” (viti 1525), shih: Vladimir Lamansky, *Secrets d’état de Venise*, Saint-Pétersbourg: 1884, f. 549.

a. 1599: “*Si accompagnano volentieri nelle fattioni gli Albanesi con li Italiani, de quali si fidano, ma non volentieri col Crovato.*” *Po aty*.

³⁷ “*Intellexi istos populos instantissime rogare arma a Venetis, ut possint contra et contra pugnare et se in Venetorum potestatem dare. Sed caveant, caveant,*

Islamizimi i shqiptarëve dhe thyerja e kontekstit tradicional fetar, krijoi vështirësi të kuptueshme në plazmimin e idesë së kombit. Për evropianët e shek. XV-XVIII, myslimanët shqiptarë nuk ishin më shqiptarë, por turq³⁸. Ky qëndrim selektiv e përjashtimor ndaj myslimanëve shqiptarë, i la këta të fundit jashtë vëmendjes dhe jashtë projekteve çlirimtare për Shqipërinë e Ballkanin, të gatuar në ata shekuj nga fuqitë evropiane. Shumë patriotë shqiptarë, nga Vaso Pasha te Nikollë Ivanaj, por dhe Thimi Mitko e arbëreshi Anselmo Lorecchio, do ta denoncojnë me forcë këtë qëndrim injorues të Evropës ndaj myslimanëve shqiptarë, që vazhdonte të ishte i tillë edhe në shek. XIX³⁹.

ne faciant, nam durius iugum imponent cervicibus, crede mihi: illam libertatem quam habent, amittent.... dic illis, accipiant arma et munitiones, si possunt ab Venetis, at in castellis, si quae acceperint, at in civitatibus non introducant Venetos, sed Albanos constituent capita et gubernatores, aliter erunt, ut Dalmatae et ceteri subditi Venetorum, sine nomine et honore. Di Parigi, Giorgio Vladagoni, 14 novembre 1647. Shih: V. Lamansky, *Secrets d'état de Venise...*, dok. nr. 31.

³⁸ Kështu, një letër të komandantit venecian të Pargës, Alessandro Fortio (1558) flitet për një pronar (pronjar) nga Mazreku i Çamërisë, i cili, na thotë dokumenti, “kur ishte shqiptar quhej Gjin Likë Kali, por tani që ishte islamizuar quhet Ahmet”. Një arsye e mjaftueshme, kjo, për t’i mohuar personit në fjalë kombësinë shqiptare e për ta konsideruar atë “turk”. ASV, *Dispacci di Ambasciatori, Rettori ed altre cariche*, b. 4, Pargë, 3 korrik 1558.

³⁹ Ishin pikërisht këto ndjenja, më shumë se bindja dhe realiteti i gjërave, që e shtynin Thimi Mitkon të deklaronte më 1886, se “*Maometant e Shqipëris jan më të mirët patriotë*”. Shih: Letër për De Radën, botuar tek *Fiamuri i Arberit*, viti III, nr. 123, 20 prill 1886, f. II; Shih dhe: Vassa Effendi, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët. Studim historik*, përkthim dhe komentim prej Mehdi Frashërit, Tiranë: 1935 (sipas botimit francez, Paris 1879), f. 101; Nikoll Ivanaj, *Conferenza tenuta in Roma all'Associazione della Stampa Italiana*, 26 gennaio 1911, Roma: Comitato Italiano “Pro Albania”, 1912, f. 15; Francesco Guida, *Ricciotti Garibaldi e il movimento nazionale albanese*, in *Archivio Storico Italiano*, anno CXXXIX, disp. 1, Firenze: 1981, f. 107. Megjithatë, pati edhe vëzhgues të huaj, të cilët u ndanë nga paragjykimi fetar, për të dhënë një gjykim të drejtë mbi zhvillimet në gjirin e shoqërisë shqiptare dhe posaçërisht për rolin e pazëvendësueshëm të myslimanëve shqiptarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Shih: Antonio Baldacci, *Itinerari Albanesi (1892-1902)*, Roma: 1917 (=Tiranë: Argeta, 2004, f. 116): “...Por ishte pikërisht islamizmi që i dha çështjes kombëtare shqiptare një impuls që deri dje i mungonte krejt”. Në vitin 1898, Teodor Ippen e kritikonte ashpër politikën e Austro-Hungarisë në Shqipëri, e cila, sipas tij, ishte përqendruar vetëm tek elementi katolik: “*Wir sind andauernd in dem Irrtume verstrickt, Scutari und das katholische*

Në fakt, njësimi në fe me pushtuesit osmanë nuk kishte arritur t'i identifikonte myslimanët shqiptarë me pushtuesit dhe nuk i kishte penguar ata të ngrinin krye kundër tyre. Në vitin 1607, Idar Maneshi, mysliman shqiptar nga malësia e Krujës, bashkë me tre mijë trima, kishte ngritur krye në malësitë e Dukagjinit, Kthellës e Selitës dhe e mbante veten si Skënderbe i ri⁴⁰. “*Turq rebelë*” dhe “*Turq që luftojnë kundër Turqve*” i quan në vitin 1661 një misionar i Papës banorët e Dukatit dhe ata të Progonatit, duke refuzuar gjithsesi t'i konsiderojë ata, bashkë me sivëllezërit e krishterë, si pjesë e të njëjtit komb shqiptar⁴¹.

Duhet shtuar se edhe për ndonjë autor arbëresh e ndonjë klerik shqiptar, “turqit” d.m.th. myslimanët shqiptarë, ishin “dele të humbura”, që mund t'i ktheheshin shqiptarisë, vetëm në rast se rikonvertoheshin në kristianizëm⁴².

Nord-Albanien für ganz Albanien zu erhalten”, shih: Anneliese Wernicke, *Theodor Anton Ippen. Ein österreichischer Diplomat und Albanienforscher*, Albanische Forschungen 7, Wiesbaden, Otto Harrassowitz, 1967, f. 34, 59. Një denoncim mbresëlënës të politikave diskriminuese të fuqive evropiane ndaj myslimanëve shqiptarë, e bëri gjatë punimeve të Kongresit të Berlinit, më 1878, konsulli rus i Manastirit, Vitrovo. Shih: Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit*, vëll. I (1867-1912), Tiranë: 8 Nëntori, 1984, f. 252-258.

⁴⁰ Letër nga Budva e Pal Dukagjinit për Dogjën e Venedikut, 1 maj 1607: “*et di novo essendo un Turcho per nome Idar Manesi sopra Croia, infra montagne, forse seguito di gente et si avea lasato dire che vuol esser un altro Scanderbeg...et detto Idar Manesi subito fece tremilia valentomini soldati et andò nella provincia di Duchagini et di Chela et Selitta unidi insieme tutti et giurati esser contra il Turcho*”. Jovan Tomić, *Građa za istoriju pokreta na Balkanu protiv Turaka krajem XVI i početkom XVII veka*. (Srpska kraljevska Akademija. Zbornik za istoriju, jezik i književnost sprskog naroda, drugo odeljenje, knjiga VI), knj. I, god. 1595-1606, Mletački državni arhiv, Beograd: 1933, nr. 251, f. 438.

⁴¹ Relacion nga Himara i mitropolitit të Durrësit, Simeon Lascari, 12 mars 1661: “*...si trova una terra detta Ducades, fà anime due mille, e qui sono anche Turchi ribelli...terra detta Progonates, fà anime due mille, Turchi come di sopra, che combattono contro Turchi*”. Shih: Marko Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vëll. I, Città del Vaticano: 1992, f. 191, 192.

⁴² Giovanni Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, a cura di Matteo Mandalà, Palermo: A. C. Mirror, 2003, f. 222; Shaban Sinani, “Besimi dhe kombësia në një vepër të pabotuar të at Gjergj Fishtës”, në: *Mendimi Shqiptar dhe Shkolla Shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Aktet e Konferencës, Tiranë 29 maj 2009, Tiranë: Plejad, 2009, f. 233-236.

Duket se nga kjo prirje tenton të shkëputet Vincenzo Dorsa, i cili në veprën e tij *Su gli Albanesi. Ricerche e pensieri*, 1847, të cilën në mënyrë kuptimplotë ia dedikon “*Kombit tim të ndarë dhe të shpërndarë, por që është një*”, përfshin në panteonin e heronjve shqiptarë, krahas Aleksandrit të Madh, Pirros e Skënderbeut, edhe myslimanët Mehmet Aliu, Ali Pashë Tepelena e Ibrahim Pasha. Megjithatë, edhe ai si shumë të tjerë, në thelb e lidhte Islamin me tiraninë, dhe për rrjedhojë, nuk arrinte ta konceptonte dot një komb shqiptar shumëfetar⁴³. Megjithatë, qysh në fund të shek. XVI, veneciani Lazaro Soranzo i konsideronte edhe myslimanët si pjesë të “kombit shqiptar”. Dardania, sipas tij, ishte e banuar “më shumë nga shqiptarë, sesa nga serbë”, duke kuptuar këtu sa të krishterët aq edhe myslimanët. E po ashtu, “komandantët turq më të shquar”, vazhdon Soranzo, “i përkasin atij kombi”, d.m.th. kombit shqiptar⁴⁴.

Vetëkuptohet që një qëndrim tjetër mbanin ndaj ndarjes fetare dhe raportit të fesë me kombësinë vetë shqiptarët e Shqipërisë. Autorët shqiptarë bënin dallimin mes atyre që cilësohen si “turchi nazionali”, dhe të ashtuquajturve “turchi albanesi”. Në fund të shek. XVII, Pashai i Shkodrës, një shqiptar, u thonte miqve të tij të krishterë, se ata nuk kishin pse trembeshin prej tij, por të trembeshin nga “turqit etnikë” (*Turchi nazionali*)⁴⁵. Ekzistonte, pra, një ndjenjë solidariteti me bazë kombëtare, të cilën, në vitin 1629, një dinjitar i fuqishëm i zonës së Lezhës, Jusuf Begu, e shprehu duke marrë në mbrojtje disa familje të krishtera, burrat e të cilave do të ishin varur nga turqit, ato vetë dhe pasuritë e tyre do ishin shitur e do ishin sekuestruar, sikur ai të mos kishte ndërhyrë në favor të tyre⁴⁶. Në vitin 1623, Pjetër Mazreku i relatonte Romës se prej 12000 turqve, që jetonin atë kohë në Prizren, “thujse të gjithë ishin shqiptarë”⁴⁷. Nga ana e tij, ipeshkvi i Shkodrës, Pjetër Bogdani, i quante myslimanët shqiptarë “bashkëkombas” (*conazionali*), duke mos harruar

⁴³ N. Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar ...*, f. 158-159.

⁴⁴ Injac Zamputi, *Dokumente të shek. XVI-XVII ...*, vëll. II (1593-1602), f. 227, 233.

⁴⁵ Peter Bartl, *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert*, vëll. I, Wiesbaden: 1975, f. 62, 63, 70.

⁴⁶ Lorenzo Tachella, *Il cattolicesimo in Albania*, Verona: 1984, f. 8.

⁴⁷ “*Ha Priseren dunque de Turchi 12000 anime...quasi tutti Albanesi*”, shih: I. Zamputi, *Relazione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII*, vëll. I, f. 336.

të kujtojë edhe lidhjet familjare që ekzistonin mes tyre e të krishterëve⁴⁸. Atë kohë, misionarët e huaj vërenin, jo pa u skandalizuar, se të krishterë shqiptarë jetonin normalisht mes myslimanëve e bashkë me ta, dhe reflektonin të njëjtat sjellje, përdornin të njëjtin zhargon⁴⁹, hanin, pinin e zbaviteshin së bashku, dhe kur i zinte nata, edhe flinin në shtëpinë e njëri-tjetrit⁵⁰. Ajo çka i linte pa mend misionarët e huaj, ishte përdhosja, sipas tyre, e misterit të vdekjes, që shprehej në ekzistencën e varrezave të përziera apo në pjesëmarrjen e “të pafeve” në varrimin e të krishterëve, dhe anasjelltas, ku secili, sipas besimit të vet, lutej për shpirtin e të vdekurit të fesë tjetër⁵¹. Në fund të fundit, shumë familje myslimane vazhdonin të ruanin kujtimin e lidhjeve të hershme familjare apo edhe miqësore me familjet e krishtera⁵². “Ekstravaganca” e shqiptarëve në punë të fesë shkonte deri aty, sa që myslimanët dhuronin, shpesh, të holla për mbajtjen e priftit apo për hapjen e shkollave për fëmijët e krishterë⁵³. Një shqiptar i ndërgjegjshëm, siç ishte ipeshkvi i Shkodrës Pjetër Bogdani, shkoi aq larg, sa t’u besonte myslimanëve edhe detyra të karakterit “kombëtar”, për të cilat propaganda evropiane quante të përshtatshëm vetëm të krishterët. Në një letër interesante të tij të 20

⁴⁸ a. 1665, 1 tetor. “(Don Pietro Trumsci), attribuendo la colpa di non haver ottenuto il Vescovato di Pulati à me, dicendo che io in luogo di promoverlo appresso cotesta Sacra Congregazione l’ho ingiurato con infamare la loro Patria, per potere con dette inventioni più facilmente rendermi odiosi, et inviperire contro di me i Turchi, con i quali è parente e conationale, e da loro molto amato”, shih: M. Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani ...*, vëll. I, f. 560.

⁴⁹ Më 1565, ipeshkvi i Lezhës kishte rënë në sy, sepse shoqërohej dhe luante me zare me “turqit”, shante e mallkonte si një “turk” dhe madje edhe vishej si “turqit”. Shih: I. Zamputi, *Dokumente të shek. XVI-XVII ...*, vëll. I (1507-1592), f. 210-212.

⁵⁰ I. Zamputi, *Relacione...*, vëll. II, f. 111, 169, 217; P. Bartl, *Quellen und Materialien ...*, vëll. I, f. 34.

⁵¹ “senza pregare per l’anima di quel Turco”, shih: Jovan Radonić, *Rimska kurija i južnoslovenske zemlje XVI-XIX vj.*, Beograd: 1950, f. 166.

⁵² Kështu, rreth vitit 1700, arqipeshkvi i Tivarit e konsideronte si “mik të shtrenjtë e të dashur” të tij Pashain e Shkodrës (*mio caro et amato amico*), me të cilin kishte një “lidhje të hershme familjare”. Shih: P. Bartl, *Quellen und Materialien ...*, f. 39, 58, 64, 67.

⁵³ K. Mertzios, “Tò en Venetia kratikon archeion”, në: *Epeirotikà Chronikà*, 15, 1940, f. 7, 9; I. Zamputi, *Relacione ...*, vëll. I, f. 143; François Pouqueville, *Storia della Rigenerazione della Grecia*, Lugano: 1858, f. 102.

tetorit 1658, Bogdani shpreh shpresën, se shpëtimi i Shqipërisë do të vinte nga një Skënderbe i dytë, që, sipas tij, mund të ishte edhe ndonjë renegat mysliman shqiptar “me ndjenja dhe i prirë për vepra të mira” (apo “patriot”, siç do ta thoshim ne në gjuhën e sotme)⁵⁴.

Siç po shihet, në këtë mënyrë po i afrohem thelbit të ideologjisë së Rilindjes Kombëtare të shek. XIX, që parashihte kapërcimin e dallimeve fetare në emër të interesave të përbashkëta të lirisë dhe të një shteti shqiptar. Tashmë, ekzistonte në xhepa të caktuar të shoqërisë shqiptare një koncept paramodern mbi kombin, që më së paku relativizonte rëndësinë e identitetit fetar. Qysh për ipeshkvin e Stefanisë, Nikollë Mekajshin (1610), kombi shqiptar, i bazuar në lidhjet e gjuhës e të gjakut, ishte një koncept i gjerë, që nuk njihte kufij fetarë: përveç të krishterëve, katolikë e ortodoksë, ai përfshinte edhe myslimanët shqiptarë dhe, akoma më tej, edhe arbëreshët e Italisë.⁵⁵ Në kushte të tilla, kur misionarët e huaj e konsideronin të papranueshëm çdo kontakt të të krishterëve me myslimanët, ndërkohë që vetë të krishterët shqiptarë i konsideronin këta si pjesë të tyre, kuptohet që këtu qëndronte edhe arsyeja përse komunitetet katolike të Shqipërisë së Veriut i kërkonin Papës që ky mos t’u dërgonte atyre klerikë të huaj: këta, mbi të gjitha, nuk dinin të silleshin me myslimanët (*per non saper il modo di vivere con Turchi*)⁵⁶!

⁵⁴ “*Si potrebbe non dimeno, un giorno caggionar qualche gran bene a questa città quando qualche renegato studioso, et abituato in qualche bona opera, et sentimento divenisse capo d’esserciti come successe sotto Amurate in Giorgio Castriotti detto Scanderbeg*”, shih: Odette Marquet, *Pjetër Bogdani. Letra dhe dokumente nga Arkivi i Kongregatës 'de Propaganda Fide' si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit*, Shkodër: Gjergj Fishta, 1997, f. 84.

⁵⁵ “*essendo che vi si trovano in poco spatio di loco in quei regni (Albania e Macedonia) più di 50 milla homini d’arme, i quali se bene sono di rito differenti, cioè greco e latino, non di meno d’un linguaggio e parenti di sangue e per matrimonio*”. Prej 20 mijë trupave napoletane, do ishte mirë të ishin edhe “*tre millia Albanesi della Puglia, i quali, se bene gran tempo che si sono trasferiti in queste parte, non di meno per la gran multitudine, che vi fù, hoggi ancora ritengono la loro natia lingua e per rispetto della lingua sarebbono di gran giovamento nell’essercito tanto per li soldati Albanesi, quanto per l’Italiani, per l’intelligenza dell’una et l’altra lingua...Onde dirò con verità, che si troveriano de’Turchi istessi potenti, che prenderianno le armi contro di lui*”, letër për Papën Pali V, 15 korrik 1610, shih: I. Zamputi, *Relacione ...*, vëll. I, f. 44, 46.

⁵⁶ I. Zamputi, *Relacione...*, vëll.II, f. 300-303.

Së fundi, përveç trajtimit ndryshe të problemit fetar, ideja kombëtare në Shqipëri hodhi hapat e para të saj edhe nëpërmjet vendosjes së raporteve me të kaluarën. Shqiptarët ndjeheshin shqiptarë dhe të lidhur me njëri-tjetrin edhe për faktin se ishin një popull me histori dhe me heronj, për të cilët ndjeheshin krenarë. Sipas Angelo Mascit, shqiptarët ishin një popull indigjen (autokton), i ndryshëm nga grekët, dhe pasardhës i popujve të lashtë të shquar për trimëri, të maqedonasve, ilirëve e epirotëve⁵⁷. Por shumë kohë përpara tij, autorë shqiptarë të shek. XV-XVII, nga Barleti te Frang Bardhi, i konsideronin shqiptarët pasardhës të këtyre popujve. Vetë Gjergj Kastrioti Skënderbeu, në letrën e tij të famshme për princin e Tarentit, Giovanni Orsinin, shprehte krenarinë e tij që ishte pasardhës i denjë i Pirros së Epirit⁵⁸. Por, nëse për Skënderbeun dhe shqiptarët e shek. XV, Pirrua i Epirit apo Aleksandri i Maqedonisë përfaqësonin një gur themelor të ndërgjegjes së tyre kombëtare, për shqiptarët e shekujve të mëvonshëm i tillë u bë Gjergj Kastrioti dhe epoka e tij. Nuk është një rastësi, që në vitin 1607, shqiptari i parë që flet për “kombin tim shqiptar”, Mark Gjini, krenohej me faktin që gjyshi i tij kishte luftuar nën urdhrat e Skënderbeut⁵⁹. Shqiptarët ndjeheshin shqiptarë edhe për arsyen se ishin bashkëkombas të Heroit. Fakti që vetë Skënderbeu kishte kaluar nëpër të gjitha përvojat fetare, e lehtësonte padyshim pranimin e tij si katalizator i të gjithëve, pa dallim feje. Qysh në vitin 1610, arqipeshkvi i Tivarit, Marin Bici, rrëfen se bëmat e Kastriotit kundër turqve tregoheshin e këndoheshin në tubimet e besimtarëve katolikë, ku shpesh herë ishin të pranishëm edhe muslimanët⁶⁰. Më 1602, shqiptarët katolikë, të mbledhur në Kuvendin e Dukagjinit, deklarorin vullnetin e tyre “për t’u kthyer këtyre trojeve tona

⁵⁷ N. Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar...*, f. 155.

⁵⁸ Jovan Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku*, Beograd: 1942, f. 121; Gennaro M. Monti, *La spedizione in Puglia di Giorgio Castriota Scanderbeg*, Bari: 1940, f. 32, 33.

⁵⁹ J. Tomić, *Građa za istoriju pokreta ...*, knj. I, god. 1595-1606, nr. 253, f. 447-449.

⁶⁰ “Nella chiesa sudetta dicono esser sepolto il famoso Alessandro Castrioto, chiamato per altro nome Scanderbegh, che si segnalò con tante valorose fattioni contra Turchi, le quali ridotte in versi si cantano in quella lingua da tutti gl’Albanesi in presenza anco dei Turchi”. Shih: I. Zamputi, *Relacione ...*, vëll. I, f. 110.

lirinë e dikurshme, që gëzonin në kohën e Princit tonë Skënderbe”⁶¹. Po atë kohë, në vitin 1577 apo 1593, himarjotët i drejtoheshin Papës duke iu prezantuar si pasardhës të mbretit (përkatësisht: princit) të tyre, Skënderbeut⁶². Edhe pas 200 vjetësh, më 1759, në promemorien e tyre për carinën e Ruisë, Elizabeta Petrovnën, himarjotët vazhdonin të identifikoheshin kombëtarisht me Pirron e Epirit dhe me Skënderbeun⁶³. Ndërkohë, Skënderbeu ishte njëherësh edhe heroi i shqiptarëve myslimanë, dhe jo rastësisht, në shek. XVII, katoliku Pjetër Bogdani apo myslimani Idar Maneshi parashikonin shfaqjen e një Skënderbeu “mysliman”⁶⁴. Nderimi për Skënderbeun u përcoll i tillë deri në prag të Rilindjes Kombëtare, duke u bërë vektor i rëndësishëm i ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve të të gjitha besimeve⁶⁵.

⁶¹ “*desiderosi recuperare tutti questi nostri paesi nell’antica libertà, sì come fù al tempo del nostro Principe Giorgio Scanderbego*”, shih: I. Zamputi, *Dokumente ...*, vëll. II, f. 272.

⁶² Letër e himarjotëve për Gregorin XIII, 12 korrik 1577: “*Notum tibi sit, Sanctissime Pater, quod olim ex quo tempore ad Deum migravit fortissimus et serenissimus Scanderbech, noster Rex, cognomento Castriotes*”, shih: I. Zamputi, *Dokumente ...*, vëll. I, f. 340. Më 1 qershor 1593, himarjotët i shkruanin Papës Klementi VIII: “*per molestar il Gran Turco, sicome fu molestato al tempo del nostro Principe Giorgio Schanderbeg... combatteremo non meno che al tempo del sudetto Principe Giorgio*”, shih: Marko Jačov, *I Balcani tra Impero Ottomano e potenze europee (sec. XVI e XVII)*, Città del Vaticano: 1995, f. 75 shën. 99.

⁶³ “Dokumente të pabotuara mbi marrëdhëniet e popullit shqiptar me Rusinë në shek. XVIII”, në: *Buletin i Shkencave Shoqërore*, Tiranë, 1955, nr. 2, f. 158. Atë kohë (1760), edhe kapiteni Spiro Bixhili, nga Dhërmiu, duke folur për shqiptarët deklaronte se “*ajo racë ka ruajtur të njëjtin shpirt si në kohët e vjetra të Skënderbeut*”. Shih: G. Arš, *È Albania kai ē Èpeiros sta tele tou IH’ kai stēs archēs tou IΘ’ aiona*, Athena: Gutemberg, 1994, f. 73, 76.

⁶⁴ O. Marquet, *Pjetër Bogdani. Letra ...*, 1997, f. 84; J. Tomić, *Grada za istoriju pokreta na Balkanu protiv Turaka krajem XVI i početkom XVII veka*, Srpska kraljevska Akademija. Zbornik za istoriju, jezik i književnost sprskog naroda, drugo odeljenje, kniga VI, knj. I, god. 1595-1606, Mletački državni arhiv, Beograd, 1933, nr. 251, f. 438.

⁶⁵ J. Tromelin, “*Itinéraire d’un voyage fait dans la Turquie d’Europe ... dans l’automne 1807*”, në: *Revue des Etudes Napoléoniennes*, Paris: 1918, vëll. XIII, f. 124.

S u m m a r y

“ALBANIAN NATION”: A SURVEY FROM MIDDLE AGES

In the foreigner`s eyes the Albanians represented in the middle ages a nation different from the Greek and Slav neighbors. Several sources specify the descendance of Albanians from the Illyrians. Certainly, the consciousness of being Albanian existed in the Albanians of middle ages. They expressed their ethnicity in Albania or outside their country by their customs, clothings, social behaviors and language. Different foreign authors stressed that Albanians spoke a language different from that of the other countries. The Albanians considered their language as an element of identity. Even Frank Bardhi in 1635 shows to the Albanian language a wariness of a renaissance when expresses his wish to “*help our language which is disrupted day by day*”.

On the other side we must say that the albanian conscience in the middle age grew upon the confrontations with the neighbor countries. In the albanian sources of XVI-XVIII centuries is shown that the albanians had language, origins, observances, way of life and history different from that of Serbs or Greeks. The last, the community`s historical consciousness can be seen clearly to Scanderbeg and his contemporaries. All these considered the Albanians as Pyrrros of Epirus and the Alexander the Great`s descendant`s. Scanderbeg become for the albanians an identificial figure. From the XVI`th century toward our days Scanderbeg become the albanians of all the times, regions and religions a basic element of their national existence and consciousness.